

VENDIM
Nr. 264, datë 31.8.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“AYEN ENERGY TRADING” SHA, PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2045/1 prot., datë 30.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 230, seria FK14/F19, të shoqërisë ‘Ayen Energy Trading’ sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2045 prot., datë 21.8.2023, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 230, seria FK14/F19, është 15.3.2024).

- Shoqëria paraqiti aplikimin për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike më datë 21.8.2023, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”.

- Në këtë aplikim konstatohet mungesa e dokumentacionit/informacionit si vijon:

- neni 16, pika 5 dhe 7: në zbatim të kushteve të licencës dhe të kërkesave të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të shlyejë ndaj ERE-s pagesat e rregullimit;

- për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE;

- në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 16.3.2024.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti